



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0598

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Isa Hasani dhe Kimete Gashi - Anëtar duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “Infosoft Systems” SH.P.K., si dhe OE “Novus” SH.P.K kundër vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ri-tender “Mirëmbajtja e 70% te HW te SISH-it për Institucionet Shëndetësore” me numër të prokurimit 206-24-1735-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “MINISTRIA E SHËNDETËSISË”, më 26/08/2024, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohen, si të pabazuara ankesat e OE “Infosoft Systems” SH.P.K., me nr. 2024/0598, e datës 05.07.2024 dhe OE “Novus” SH.P.K me nr.2024/0633 e datës 15.07.2024, lidhur me aktivitetin e “Ri-tender “Mirëmbajtja e 70% te HW te SISH-it për Institucionet Shëndetësore” me nr. të prokurimit: 206-24-1735-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) “MINISTRIA E SHËNDETËSISË”.

2. Mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin për anulim të Autoritetit Kontraktues – “MINISTRIA E SHËNDETËSISË” lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit.

3. Urdhërohet konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 21.03.2024 “MINISTRIA E SHËNDETËSISË” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ri-tender “Mirëmbajtja e 70% te HW te SISH-it për Institucionet Shëndetësore” me nr. të prokurimit: 206-24-1735-2-1-1. Ndërsa me datë 24.06.2024 AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka anuluar aktivitetin e prokurimit.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës **720,000.00 €**.

Me 27.06.2024 OE “Infosoft Systems” SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 05.07.2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 28.06.2024 OE “Novus” SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 05.07.2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 05.07.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Infosoft Systems” SH.P.K., me nr. 0598/2024 si dhe ankesa nga OE “Novus” SH.P.K me nr.0633/2024 e datës 15.07.2024, lidhur me aktivitetin “Ri-tender “Mirëmbajtja e 70% te HW te SISH-it për Institucionet Shëndetësore” me nr. të prokurimit: 206-24-1735-2-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Duke marrë parasysh faktin se të dy ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 0598/24 dhe ankesa nr. 0633/24 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE “Infosoft Systems” SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

OE Infosoft Systems Sh.P.K. pas pranimit të njoftimit mbi vendimin e AK-së për anulimin e aktivitetit në mungesë të ofertave të përgjegjshme, në pajtim me nenin 108/A të ligjit Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, brenda afatit të paraparë ligjor ka dorëzuar kërkesë për rishqyrtim, me anë të së cilës e kemi arsyetuar përgjegjshmerinë tonë dhe faktimin e konstatimeve të gabuara te AK-së. Duke mos pranuar përgjigje në kërkesen për rishqyrtim, ne përputhje me nenin 63.2 të Rregullores nr. 001-2022 për Prokurim Publik, dorëzojmë këtë ankesë pranë OSHP-së.

Pretendimet ankimore Janë të drejtuara kundër mospërgjigjes së AK-së në kërkesën për rishqyrtim, shpalljes se ofertës sonë si ofertë të papërgjegjshme, anulimin e aktivitetit të prokurimit në tërësi, dhe arsyetimet tona lidhur me përgjegjësinë e ofertës sonë! Faktet dhe argumentet: OE Infosoft Systems Sh.P.K., me datë 24.06.2024, nga platforma e e-prokurimit është njoftuar për vendimin e AK-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit, pjesë nga i cili po e paraqesim në vijim:

Vendimi i AK-së për refuzimin e ofertës sonë si të papërgjegjshme, si akte administrative bien ndesh me dispozitat e LPP-së. Përkatësisht, në kuptimin procedural bien ndeshë me nenin 59, paragrafi 4 i LPP-së, ndërsa në kuptimin profesional janë tërësisht të paqendrueshme. OE Infosoft Systems me datë 27.06.2024 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së ne pajtim me nenin 60.1 pika c, te Rregullorës nr. 001-2022, për Prokurim Publik dhe kemi pranuar njoftimin për pezullim të aktivitetit të prokurimit, por deri ne momentin e parashtrimit të kësaj ankese, data 04.07.2024, ne ende nuk kemi pranuar përgjigje, andaj AK duke mos u përgjigjur dhe duke mos na njoftuar për zgjatje të afatit për përgjigje ka vepruar në kundërshtim me nenin 61.3 të Rr. Nr. 001-2022 për Prokurim Publik Gjithashtu me datë 02.07.2024, ne e kemi kontaktuar me anë te e-mail, por skemi pranuar përgjigje, si më poshtë:

Po me të njëjtën datë kolegu ynë ka biseduar me telefon përmes numrit që ndodhet në DT, me personin përgjegjës nga AK-ja për këtë aktivitet të prokurimit, i cili na konfirmoj pranimin e emailit, dhe poashtu “qe sot pasdite ose nesër më së largu” do të pranojmë përgjigjen në kërkesën për rishqyrtim. Por jo, ne ende nuk kemi pranuar asnjë informatë nga ana e AK-së! OE Infosoft Systems Sh.P.K. të gjitha

funkcionet e kërkuara nga AK në këtë aktivitet të prokurimit ka menduar ti mbulojë me staf - inxhinierë të specializuar dhe certifikuar në fushat e kërkuara.

Për funksionet që janë paraparë nga AK të mbulohen nga stafi me certifikata në pozicionin c) “(dy) VMware VCP Datacenter”, ne kemi dorëzuar dokumentet në përputhje me kërkesat minimale, dhe atë me punëtorin Arbnor Mehana, i diplomuar në shkencë kompjuterike dhe i pajisur me certifikatën “VMware Certified Profesional Datacenter Virtualisation” dhe me punëtorin Fatlum Mujko po ashtu i pajisur me certifikatën e kërkuar “VMware Certified Profesional Datacenter Virtualisation”.

Për këta punëtorë, si dhe për stafin tjetër të dedikuar për këtë projekt janë plotësuar të gjitha kërkesat dhe deshmimet dokumentare të cilat deshmojnë kapacitetin teknik dhe profesional të OE Infosoft Systems Sh.P.K., të cilat janë në pajtim të plotë me kërkesat në FDT. Për funksionin që është paraparë të mbulohet nga staf me certifikatë në pozicionin d) një VMware Horizon, kemi dorëzuar dokumentet në përputhje me kërkesat minimale, dhe atë me punëtorin Arbnor Mehana i diplomuar në shkencë kompjuterike dhe i pajisur me certifikatën përkatëse “VMware Horizon 7.

Install, Configure and Manage”. OE Infosoft Systems, me përvojën që e ka fituar ndër vite me projekte të natyrës së njejtë, e ka kuptuar në mënyrë saktë kërkesën e AK-së për obligimet dhe përgjegjësitë që duhet të mbulohen nga OE konkurent lidhur me kërkesat obligative të pikës 2 të kapacitetit teknik dhe profesional, e në veçanti kërkesat c) dhe d), dhe ato si pozicione redundante, pra që stafi i i dedikuar për këtë projekt të jetë në gjendje që të mbulojnë njëri tjetrin, konkretisht, me rastin e angazhimit të stafit të ngarkuar brenda këtij projekti në ndonjë projekt tjetër, atëherë personi tjetër i dedikuar të mund të mbulojë përgjegjësitë e tij, si dhe në rast pushimi vjetor apo të ngjajshëm.

Për të dëshmuar këtë, ne për funksionet e kërkuara në pikat c dhe d, edhe e kemi ofruar stafin e cekur më sipër, duke deklaruar që në mënyrë të plotë dhe me përgjegjësi të lartë profesionale do të mbulojmë dhe realizojmë obligimet e parapara nga AK-ja në këtë aktivitet shumë të rëndësishëm për sistemin shëndetësor në vendin tonë. Për sqarim të metutjeshëm të rrethanave, OE Infosoft Systems Sh.P.K., pas dorëzimit të tenderëve, me datën: 22.05.2024, kemi pranuar nga AK letren standarde për sqarimin e tenderit pikërisht për pozicionet në fjalë, pjesë nga e cila kërkesë për sqarime po e paraqesim në vijim

Me datë: 27.05.2024 i’u kemi përgjigjur AK-së, duke i sqaruar si më lartë se me cilin staf, konkretisht me cilat certifikata do të mbulojmë funksionet e kërkuara, por sqarime këto të cilat nuk kanë qenë të mjaftueshme për komisionin vlerësues të AK-së, të cilët duke mos e parë të arsyeshme të kërkojnë sqarime apo deklarata shtesë, të cilat u’a mundëson neni 72 i LPP-së, me datë 24.06.2024 publikojnë njoftimin për anulimin në tërësi të aktivitetit të prokurimit, pjesë nga i cili, konkretisht arsyen e refuzimit të ofertës sonë po e bashkëngjesim në vijim, me ç’rast AK ka vepruar edhe në kundërshtim me nenin 59.2 të LPP-së. Pjesë nga Njoftimi mbi Vendimin.

Për të sqaruar me tutje, dhe në menyrë edhe me të detajuar përgjegjshmerinë tonë, sigurimin që i kemi kuptuar saktësisht kërkesat e AK-së dhe garantimin e kryerjes se obligimeve të kërkuara, lidhur me kërkesat për staf me certifikata “VCP” dhe “VMware Horizon”, në vijim po i cekim detyrat dhe përgjegjësitë kryesore profesionale të inxhinierëve të pajisur me këto dy certifikata: Inxhinierët e certifikuar me VMware VCP Datacenter (kërkesa c) janë të paraparë për të mbuluar detyrat dhe përgjegjësitë e sqaruara më poshtë.

Përgjegjësi të cilat i kemi sqaruar në atë mënyrë që të jenë lehtësisht të kuptueshme për stafin e komisionit vlerësues me background të IT-së dhe jo IT: 1. Menaxhimi i Infrastrukturës Virtuale: Shpjegimi: Menaxhon makinat virtuale (VM) dhe burimet e pajisjeve që ato përdorin.

Thjeshtuar: Sigurohet që të gjitha hapësirat e punës dixhitale (kompjuterët brenda kompjuterëve) të funksionojnë pa probleme dhe me efikasitet të plotë!

2. Caktimi i Resurseve: Shpjegimi:

Ndanë resurset e CPU-së, memories dhe hapësirës së ruajtjes për makinat virtuale bazuar në nevojat e organizatës. Thjeshtuar: Vendos se sa fuqi, memorie dhe hapësirë ruajtjeje do të marrë secila hapësirë pune dixhitale, duke siguruar që asnjëra të mos përdorë shumë apo pak.

3. Monitorimi dhe Mirëmbajtja:

Shpjegimi: Monitoron performancën dhe shëndetin e mjedisit virtual dhe kryen përditësime dhe mirëmbajtje të nevojshme. Thjeshtuar: Mbikëqyr shëndetin e sistemit, duke rregulluar problemet dhe përditësuar softuerin për të mbajtur gjithçka në gjendje të mirë. 4. Backup dhe Rikuperimi:

Shpjegimi: Implementon dhe menaxhon zgjidhjet e backup-it dhe planet e rikuperimit për të mbrojtur të dhënat dhe për të siguruar vazhdimësinë e funksionimit të punës. Thjeshtuar: Sigurohet që të gjitha të dhënat e rëndësishme të jenë të ruajtura dhe të rikuperueshme në rast se diçka shkon keq.

5. Menaxhimi i Sigurisë:

Shpjegimi: Siguron që mjedisi virtual të jetë i mbrojtur nga qasjet e paautorizuara dhe kërcënimet.
Thjeshtuar: Mbron sistemin nga hakerat dhe përdoruesit e paautorizuar.

6. Diagnostikimi i Problemeve: Shpjegimi:

Diagnostifikon dhe zgjidh problemet brenda mjedisit virtual. Thjeshtuar: Zgjidh problemet që shkaktojnë mosfunksionimin ose ngadalësimin e hapësirave të punës dixhitale. Inxhinierët e certifikuar me VMware Horizon (kërkesa d) janë të paraparë për të mbuluar detyrat dhe përgjegjësitë të sqaruara në vijim. Përgjegjësi të cilat i kemi sqaruar në atë mënyrë që të jenë lehtësisht të kuptueshme për stafin e komisionit vlerësues të AK-së me background të IT-së dhe jo IT:

1. Menaxhimi i Infrastrukturës së Desktopëve Virtualë (VDI): Shpjegimi: Menaxhon dhe vendos desktopët virtualë, duke lejuar përdoruesit të kenë qasje në desktopët e tyre nga distanca. Thjeshtuar: Vendos dhe menaxhon desktopët dixhitalë që njerëzit mund t'i përdorin nga çdo vend, sikur të ishin kompjuterët e tyre fizikë në zyrë.

2. Qasja dhe Përvoja e Përdoruesit: Shpjegimi: Siguron që përdoruesit të kenë qasje të lehtë dhe të sigurt në desktopët e tyre virtualë me një përvojë optimale. Thjeshtuar: Sigurohet që përdoruesit të mund të përdorin lehtësisht dhe në mënyrë të sigurt desktopët e tyre dixhitalë, duke e bërë të ndjehet sikur përdorin kompjuterin e tyre të zakonshëm.

3. Shpërndarja e Aplikacioneve: Shpjegimi: Shpërndan aplikacione në desktopët virtualë, duke siguruar që ato të jenë të disponueshme dhe të performojnë mirë. Thjeshtuar: Sigurohet që të gjitha softuerët e nevojshëm të jenë të disponueshëm në desktopët dixhitalë dhe të funksionojnë mirë. 4. Siguria dhe Përputhshmëria:

Shpjegimi: Implementon masa sigurie dhe siguron përputhshmërinë me politikat dhe rregulloret e organizatës. Thjeshtuar: Siguron desktopët dixhitalë kundër kërcënimeve dhe sigurohet që gjithçka përputhet me rregullat dhe rregulloret e kompanisë.

5. Shkallëzimi dhe Përmirësimi i Performancës:

Shpjegimi: Optimizon dhe shkallëzon mjedisin e VDI për të përmbushur nevojat në ndryshim të biznesit dhe kërkesat e përdoruesve. Thjeshtuar: Përshtat sistemin për të trajtuar më shumë përdorues ose për të përmirësuar performancën sipas nevojës.

6. Mbështetja dhe Trajnimi: Shpjegimi:

Ofron mbështetje për përdoruesit fundorë dhe i trajnon ata për përdorimin efektiv të desktopëve virtualë. Thjeshtuar: Ndhmon përdoruesit me çdo problem që hasin dhe i mëson ata si të përdorin si duhet desktopët e tyre dixhitalë. Përmbledhje e shkurtë e përgjegjësive të dy certifikimeve: Inxhinieri i Certifikuar me “VMware VCP Datacenter”: Sigurohet që hapësirat e punës dixhitale (kompjuterët brenda kompjuterëve) të funksionojnë pa probleme, të jenë të sigurta dhe me efikasitet, me të gjitha të dhënat e ruajtura. Inxhinieri i Certifikuar me “VMware Horizon”: Menaxhon dhe optimizon desktopët dixhitalë që punonjësit mund të përdorin nga distanca, duke siguruar që funksionojnë mirë dhe në mënyrë të sigurtë, duke ofruar mbështetje dhe trajnim për përdoruesit.

Të ndëruar anëtar të Panelit Shqyrtues dhe ju ekspertë shqyrtues profesional të OSHP-së, ju lutem ti krahasoni me vemendje detyrat dhe përgjegjësitë që vijnë së bashku me certifikimet përkatëse për “VCP” dhe për “VMware Horizon”, dhe do ta shihni që asnjëra nga to nuk nevojitet të kryhet njëkohësisht në vende të ndryshme dhe nga persona të ndryshëm, pra mundët pa problem që proceset të kryhen ndarasi dhe në menyrë redundante nga stafi ynë i dedikuar për këtë projekt. Pra e cekim edhe njëherë që ne e kemi kuptuar në menyrë të qartë kërkesën për redundancë të kryerjes së funksioneve dhe që nuk behët fjalë për numër stafi (persona) por për certifikatë (staf profesional të certifikuar) dhe kryerje të funksionit të kërkuar.

Pra arsyetimi i AK-së lidhur me refuzimin e ofertës sonë është i paqendrueshëm dhe i pa bazë Për të sqaruar edhe me tutje rastin tonë, kur një inxhinier i pajisur me dy certifikata të kërkuara, ofrohet të mbulojë dy funksione jo të ndërlidhura dhe që të njejtat në asnjë rrethanë nuk lypsen të kryhen në të njejtën kohë, me qëllim të lehtësimit të vendimmarrjes dhe vlerësimit objektiv të rastit, po e bashkëngjisim edhe një rekomandim të ekspertit shqyrtues të prokurimit lidhur me ankesën pranë OSHP-së me numër rendor 0581/2023, si rrjedhojë e të cilit është nxjerrë edhe vendimi për aprovim nga ana e Panelit Shqyrtues të OSHP-së, pjesë nga rekomandimi i të cilit po e paraqesim në vijim

Në këtë aktivitet të prokurimit publik, OE i propozuar për kontratë, për tri funksione të ndryshme brenda projektit ka aplikuar me personin e njejtë i cili është i pajisur me certifikatat e kërkuara, dhe rekomandimi i ekspertit shqyrtues të OSHP-së ka qenë që aktiviteti, ndër të tjera, të kthehet në rivlerësim dhe gjatë rivlerësimit komisioni të kërkojë sqarime nga njësia kërkuuese se a mund të përmbushet kërkesa me një ekspert për të trija fushat. Rekomandimi është aprovuar nga Paneli Shqyrtues, lënda është kthyer në rivlerësim.

Pastaj ne e kemi hulumtuar si ka vijuar aktiviteti me tutje nga ana e AK-së dhe e kemi parë që pas rivlerësimit është shpallur përseri fitues OE i rekomanduar herën e parë, e që nënkuptohet se edhe për komisionin rivlerësues të AK-së ka qënë në rregull që një person i angazhuar me kontratë mbi vepër të mbuloj tri funksione me tri certifikata të ndryshme brenda projektit të njejtë.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër OE “Infosoft Systems” SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin **Neni 1 Qëllimi; Neni 51 Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes; Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve; Neni 72 Sqarimet shtesë; Neni 61.3 i RrPP nr.001-2022.** Përfundimi dhe Kërkesa Bazuar në argumentet si dhe provat e bashkangjitura është vërtetuar se AK ka marrë vendim i cili ka shkelje të theksuara procedurale dhe materiale. Andaj, në si parashtrues të kësaj ankese, kërkojmë nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së që ankesën tonë ta aprovoni si të bazuar, të sjellni vendim për anulimin e njoftimit mbi vendimin e AK-së dhe ta ktheni aktivitetin në rivlerësim. Vlerësimi të bëhet konform dispozitave të rregullativës së prokurimit publik në Kosovë (LPP dhe RrPP) përkatësisht në raport me kërkesat e dosjes së tenderit.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim: OE “Infosoft Systems” SH.P.K.: "Sa i përket vonësës në kthimin e përgjigjes në kërkesën tuaj për rishqyrtim, ju njoftojmë se ne kemi qene duke e shqyrtuar këtë kërkesë, por për shkak të rëndësisë së lëndës kemi pasur konsultime edhe me profesionistët e lamise teknike dhe administrative, duke u munduar se nese ka mundësi ligjore për ti pranuar pretendimet e juaja në këtë ankese.

Pretendimet e juaja ankimore janë të pa bazuara, duke marrë parasysh se nuk i keni plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara në NJK dhe DT, andaj mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin e AK i datës 24.06.2024 dhe arsyet për eliminim sipas Letrës Standarde për tenderuesin e eliminuar.

Te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, në lidhje me stafin profesional, kriteri ka qene mjaft i qarte dhe numri i stafit ka qene i specifikuar edhe me numër 1 dhe me fjale (një), si dhe me numër 2 dhe me fjale (dy).

Para se të plotësohen kualifikimet e profesionistëve, fillimisht duhet të plotësohet numri i tyre siç është kërkuar $1 + 2 + 2 + 1 = 6$ ekspert të këtyre profileve.

Kriteri i NJK dhe DT ka qene mjaft i qarte, me përshkrimin si më poshtë:

Ju keni ofruar këtë listë të stafit. Lista si qeshte e paraqitur ne përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim

Nga kjo liste dhe dokumentacioni i ofertës u mungon edhe një profesionist, meqenëse për piken c) janë kërkuar 2 (dy) VMware VCP Datacenter, ndërsa për piken d) është kërkuar 1 (një) ~~VMware Horizon~~. Ju e keni ofruar vetëm Arbnor Mehana dhe Fatlum Mujko për te dy pozitat c) dhe d).

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Novus” SH.P.K për ankesën me nr.2024/0633 janë parashtruar si në vijim:

Sipas Vendimit në bazë të Cilit është refuzuar Kërkesa për Rishqyrtim e OE NOVUS Sh.P.K. është theksuar se të njëjtit nuk e kundërshtojnë dhënien e provimit sipas Kërkesës teknike pika d) që të kryhet provimi VMware horizon dhe profesionalizmit megjithatë dulce qenë se mungon kopja e noterizuar e certifikatës horizon apo të dëshmohet me link atëherë konsiderohet se nuk ka përmbushur këtë kërkesë teknike dhe si të tille oferta e OE NOVUS konsiderohet e papërgjegjshme.

Pretendimi Ankimor 1: OE NOVUS KA DORËZUAR OFERTË TË PËRGJEGJSHME

Sikurse është sqaruar në Kërkesën për Rishqyrtim nga ana e OE Novus, Genc Jakupi ka përfunduar provimin për certifikatën e kërkuar nga AK të sqaruar në NJK dhe DT pika d). Megjithatë për shkak të ndryshimeve të brendshme të VMware, dëshmia për mbajtjen e trajnimit ka qenë e pamundur të migrohet në platformën e re. OE NOVUS është ende në pritje të përgjigjes nga VMware për rregullimin dhe evitimin e këtyre pengesave. Sipas informatave të marra nga VMware, kroces kanë rirë platformën ekzistuese të VMware. deri më datë 6 maj 2024, prandaj sistemi i ri është ende në përpilim nga ana e tyre. Deri në njoftimin e ardhshëm nga VMware nuk mund të sigurohet certifikata mbi përfundimin e VMware Horizon por kjo nuk e anashkalon faktin që z. Genc Jakupi ka përfunduar të gjitha certifikimet që përfshijnë trajnimet e nevojshme të VMware dhe certifikata konsiderohet vetëm teknikalitet për të konfirmuar pikat që vecse janë dëshmuar nga OE Novus.

OE NOVI-JS në këtë rast përmes Kërkesës për Rishqyrtim ka sqaruar se trajnimi veçse ka përfunduar si dhe të gjitha procedurat e tjera nëpër të cilat është dashur të kalohet. Megjithatë ky proces ka hasur në pengesa të tjera të cilat nuk kanë asnjë lidhje me OE NOVUS apo me ofertën e tij, tejkalimi i të cilave nuk mund të varet nga vullneti i OE NOVUS. VMware është në periudhë të ndryshimeve të brendshme të ristrukturimit dhe e njëjta është në proces të kalimit në Broadcom, dhe kjo mund të dëshmohet në linkun e VMware portalit

<https://vmware.my.site.com/partnerconnect/s/>.

Mbi bazën faktike të elaboruar më sipër, Vendimi i datës 05.07.2024 i AK-së pa të drejtë ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të OE NOVUS, kështu duke vepruar në kundërshtim me nenin 59, paragrafin 4, dhe nenin 62 të Ligjit Nr. 05/L-042. Fillimisht, neni 59, paragrafi 4 përcakton se një tender vlerësohet si i përgjegjshëm po qe se i plotëson të gjitha kushtet e specifikuar në dosjen e tenderit, ndërsa neni 62 shprehimisht ka përcaktuar shkaqet për të cilat mund të përfundojë një aktivitet i prokurimit. AK është dashur të sqaroj përgjegjshmërinë e ofertës në bazë të nenit 40, paragrafit 6 dhe 7 të Rregullores Nr. 01/2022, sipas së cilave AK nuk mundet shpallë si të papërgjegjshme ofertën nëse dokumentet e dorëzuara nuk dallojnë esencialisht nga kushtet dhe specifikimet në dosjen e tenderit, Në rastin tonë dokumentet e dorëzuara kanë vërtetuar plotësimin e të gjitha kushteve dhe specifikimeve, siç dëftohet edhe nga vet AK në Vendimin e datës 21.06.2024.

Duke qenë se oferta e NOVUS është e përgjegjshme, nuk plotësohen kushtet për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Pretendimi Ankimor 2: NUK JANË PLOTËSUAR KUSHTET LIGJORE OË TË MUND PËRFUNDOHET AKTIVITETI I PROKURIMIT

Neni 62 i LPP-së shprehimisht ka përcaktuar shkaqet për të cilat mund të përfundojë një aktivitet i prokurimit:

"1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e Cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke ë shirë edhe rastet ku në dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit;

1.2. të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që në masë substanciale e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo

1.3. para hapjes së tenderëve, ndërprelja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikoheshin në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit.

Në rastin konkret rezulton se nuk janë plotësuar asnjëri nga kushtet e mësipërme. Megjithatë, AK ka anuluar aktivitetin e prokurimit me arsyetimin se "asnjë nga ofertat e pranuar nuk është e përgjegjshme

Kjo përkundër se, siç keni elaboruar edhe më sipër, OE NOVUS ka dorëzuar ofertë të përgjegjshme dhe ekonomikisht të favorshme - me çmim nën vlerën e parashikuar nga AK.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër OE "Novus" SH.P.K konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 dhe 62 të LPP-së. Në raste të tilla, kur dorëzohet një ofertë e përgjegjshme dhe e cila i plotëson të dy kriteret vendimtare për tu shpërblyer me kontratë, AK nuk mund të përfundojë aktivitetin e prokurimit, por duhet ta shpërblejë me kontratë OE që dorëzon një ofertë të tillë. Kjo në mënyrë që, fillimisht të arrihet/realizohet synimi për të cilin AK fillimisht ka inicuar/hapur aktivitetin e prokurimit, e më pas, edhe për arsye që të mos dëmtohet OE i cili ka ofertuar dhe ka pasur shpenzime monetare për këtë gjë - ofertim. KËRKESA: Mbi bazën e argumenteve të mësipërme, ftohet Organi

Shqyrtues i Prokurimit që të nxjerr Vendim ashtu që: I.Aprovohet Ankesa e NOVUS SH.P.K. kundër Vendimit të AK të datës 05.07.2024 si e bazuar; ashtu që II. Anulohet Njoftimin i datës 21.06.2024 i lëshuar nga Autoriteti Kontraktues "Ministria e Shëndetësisë", përmes të cilit AK ka anuluar aktivitetin e prokurimit me pretendimin se asnjë nga ofertuesit nuk ka paraqitur ofertë të përgjegjshme.

Përgjigje ne kërkesën për rishqyrtim: "Novus" SH.P.K : "Përgjigjia e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimet Ankimore te OE ankues:

Sa i perket voneses ne kthimin e pergjigjes ne kerkesen tuaj per rishqyrtim, ju njoftojme se ne kemi qene duke e shqyrtuar kete kerkese, por per shkak te rendesise se lendes kemi pasur konsultime edhe me profesionistet e lamise teknike dhe administrative, duke u munduar se nese ka mundesi ligjore per ti pranuar. pretendimet e juaja ne kete ankese.

Pretendimet e juaja ankimore jane te pa bazuara, duke marre parasysh se nuk i keni plotesuar te gjitha kriteret e kerkuara ne NJK dhe DT, andaj mbetet ne fuqi Njoftimi mbi Vendimin e AK i datës 24.06.2024 dhe arsyet per eliminim sipas Letres Standarde per tenderuesin e eliminuar.

Te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, ne lidhje me stafin profesional te kerkuar, pika d, kriteri ka qene mjaft i qarte ku eshte kerkuar:

d) 1(një) VMvware Horizon. Inxhinier i diplomuar në inxhinieri, Shkenca kompjuterike apo inxhinier i elektroteknikës

Dëshmia e kërkuar clockunientare:

d) CV-në, Kopja e noterizuar e Çertifikatës VMware Horizon apo të dëshmohet me link. Kopjen e diplomës Universitare në inxhinieri Shkenca kompjuterike apo inxhinier i elektroteknikës si dhe kopjen e kontratës se punës apo para-kontratës për këtë projekt.

Bazuar ne sqarimet e dhena nga ana juaj edhe pse te vonuara sa i përket afatit, gjate procesit te vlerësimit te ofertave, si dhe ne kete kerkese per rishqyrtim, ne si AK-MSh nuk e kundërshtojmë arsyetimin e juaj se z. Genc Jakupi sipas jush e ka perfunduar dhenien e provimit për VMware Horizon dhe profesionalizmin e ekspertit ne fjale, por anetaret profesional te komisionit vleresues mbeten te mendimit se nuk eshte plotësuar kriteri i kerkuar ne NJKdhe DT, meqense eshte kerkuar Kopja e noterizuar e Çertifikatës VMware Horizon apo të dëshmohet me link , e te cilen nuk e keni ofruar per z. Genc Jakupi.

d.m.th. edhe nese e ka kryer provimin dhe e ka nivelin e profesionalizmit, mungon Kopja e noterizuar e Çertifikatës si dokument i kerkuar per ta plotesuar kriterin.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shyrtues i Prokurimit me datë 10.07.2024 si dhe me datën 18.07.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0598/2024 si dhe ankesës me nr. 0633/2024.

Lidhur me ankesën nr. 0598/24 me datë 17.07.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/0598 me rekomandimet si në vijim: Eksperti shqyrtues pas shqyrtimit te pretendimeve ankimore, shqyrtimit te terë dokumentacionit te ofertës ne baze te Nenit 114 rekomandon PSH.OSHP qe te REFUZOJ ankesën e OE si te PA BAZUAR dhe te mbetet ne fuqi Njoftimi mbi vendimin e AK-së.

Lidhur me ankesën nr. 0633/24 me datë 26.07.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me Nr. 2024/0633 me rekomandimet si në vijim: Eksperti shqyrtues pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, shqyrtimit të tërë dokumentacionit të ofertës në bazë të Nenit 114 rekomandon PSH.OSHP që të REFUZOJ ankesën e OE si të PA BAZUAR dhe të mbetet në fuqi Njoftimi mbi vendimin e AK-së.

Raportin e ekspertizës me nr.0598/24 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se Pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, po ashtu edhe OE Nuk Pajtohet lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Raportin e ekspertizës me nr.0633/24 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, pajtohet ndërsa OE nuk pajtohet rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritues lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrirat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “Infosoft Systems” SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0598 ka vlerësuar si në vijim:

PËRGJEGJIA E EKSPERTIT SHQYRTUES: Autoriteti Kontraktues në Dosjen e tenderti tek kapaciteti teknik dhe profesional ka kërkuar me sa vijon:

Në bazë të kësaj operatori ekonomik ankues ka prezantuar në dosjen e tenderti stafin sipas listës me sa vijon

Sipas listës dhe dokumentacionit të eprezantuar në ofertë nga ana e OE për pikën c dhe d janë prezantuar stafit apo punëtorët:

1.Arbnor Mehana dhe

2.Fatlum Mujko.

Bazuar në këtë AK-MSH konform LPP-së Nenit 72 me datën 22.05.2024 ka kërkuar sqarime shpesh lidhur me këtë nga ana e OE-së me tekstin si në vijim:

Operatori ekonomik është përgjegjës me datën 27.05.2024 ndaj kërkesës për sqarime me qrast ka konfirmuar se punëtorët nga lista Arbnor Mehana dhe Fatlum Mujko janë staf i OE për këtë kërkesë.

Dhe me këtë rast është vërtetuar që OE lidhur me kërkesën e pikës c sipas sqarimit dhe listës së prezantuar ka ofertuar vetëm me një punëtorë, kurse AK për këtë pikë ka kërkuar dy (2) punëtorë

andaj bazuar ne këtë ne cilesin e ekspertit shqyrtues konstatoj se operatori ekonomik nuk ka ofruar 2 (dy) punëtor sipas kërkesës dhe nuk ploteson këtë pikë dhe se pretendimi ankimore është i pa bazuar. Parimisht nuk ka mundesi qe 2 (dy) pozicione te mbulohen me një punëtorë. Kurse për pikën d te kërkesës se dosjes është prezantuar punëtori Fatlum Mujko.

PRETENDIMI ANKIMORE NR.2: KA TE BËJ ME MOS PËRGJEGJIEN E AK-së ne KERKESEN PËR RISHYQRTIM T EPARAQITUR NGA ANA E OE-së.

PËRGJEGJIA E EKSPERTIT SHQYRTUES:

Operatori ekonomik ankues ne baze te njoftimit mbi vendimin e AK dhe letrave standarde konform LPP-së Nenit 108/A paragrafit 3.3 ka parashtuar Kerkesen për rishqyrtim me daten 27.06.2024 përmes sistemit te e-prokurimit.

Ne baze te LPP-së Nenit 108/A, paragrafit 6. Autoriteti kontraktues do ta shqyrtojë kërkesën brenda tre (3) ditë pune nga data e dorëzimit të aplikimit ose, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes së informatave shtesë dhe dokumenteve të parashikuara në paragrafin 5 të këtij neni. Afati i përmendur më lart, në raste specifike të justifikuara mund të zgjatet për jo më shumë se tre (3) ditë shtesë, dhe ankuesi do të informohet për këtë.

Autoriteti kontraktues Vendimin si përgjegji ndaj kërkesës për rishqyrtim e ka nxerrur me daten 05.07.2024 që i bi ne ditën nëntë (9)

dhe bazuar ne Nenit 108/A paragrafin 6 i bi se vendimin AK e ka leshuar jashtë afatëshme. Andaj ne baze te RrPP-së nr.001/2022 Neni 97 Shkeljet e rënda, pika e.) Mos respektimi i rregullave për trajtimin e kërkesave për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues dhe kjo mbetet nen pergjegjesin e Autoriteti Kontraktues.

Lidhur me pretendimet e OE “Novus” SH.P.K eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0633 ka vlerësuar si në vijim:

Pretendimi ankimore nr.1 i operatorit ekonomik ka te bëj me eliminimin e ofertës se tij si te pa përgjegjeshme sipas arsytiveve te paraqitura nga AK ne njoftimit mbi Letren standarde eliminuese si ne vijim:

PËRGJEGJIA E EKSPERTIT SHQYRTUES NDAJ PRETENDIMEVE ANKIMORE TE PARAQIURA SI MË LARTË: Autoriteti Kontraktues ne Dojen e tenderit ka kërkuar si ne vijim:

Operatori ekonomik NOVUS SIIPK ne closjen e ka ofertuar me CV e Genc Jakupi, ne bazë te kërkesës se DT-së i njeti ka prezantuar ne ofertë CV, Kopjen e diplomes universitare për shkencat kompjuterike si dhe kontraten e punës lidhur me projektin ne fjalë këto dolcumente plotesojn kriterin e kërkuar ne DT nga ana e AK, por OE për Genc Jakupi nuk ka prezantuar Certifikaten VMware Horizon siq është e kërkuar me DT, Ne baze te Ncnit 72 te LPP-së me daten 2205.2024 AK me anë te Letres standarde për sqarime ka kërkuar sqarim lidhur me plotesimin e pikës d) nga ana e OE me teksitn si ne vijim:

Ne pozitën d, eshte kërkuar qe te jete pozita me certifikat ne VMware Ilorizon, fidërsa ju keni dëshmuar se vetëm ka hyre ne test dhe se ka kaluar, nuk mund te verifikojm se a eshte valide ju lutem te siguron certifikatën e zt.Genc Jakupi ose linkun se ku mundemi qe te verifikojm me Candidate ID ne VMware.

Me datën 30.05.2024 OE, ankues NOVUS SHPK ka dërguar përgjegjien tekë AK ku ka thekësuar:

PERGJIGJJE: Inxhiniëri Uparaqitur përvoztitën VMware Horizon, Genc Jakupi, ka përfunduar dhënien e provirnit për mart-jen e certifikotës VMware Horizon, mirëpo poro fazës se kalirnit të VMware ne Broadcom marrje e certifikotës shoqërohet dhë me përfundimin dhe trajnimit për atë kvrs, Trojnimi veq ka përfunduar, mirëpo për shkak të kalimit të VMware ne Broadcorn, dëshmia për mbojtjen e trajnimit kanë qenë e pamundur që të migrohet ne platformën e re dhe tani jerni në pritje të VMwore se kur kjo pjese do të mund të rregullohet, Pasi qe deri me datën 6 Maj 2024 gjithçka ka qene e ngrire ne platformnën ekzistuese të VMware dhe sisterni i ri është ende ne përpilim e sipër,

Megjithatë me përfundimin e provimit, certifikimi Ilogorit si i përfunduar dhe së shpejti presim që të bëhet e fTVJndUr edhe marrja e certifikatës për VMwore Horizonl

Me poshtë dhe njoftimi zyrtar nga VMware qe ka ndryshime ne mënyrën e certifikimit dhe trajtimi.

PERGJIGJJE:Sa i përkët pozitës per CCNAI kërkesa ne dosjen e tenderit ka qene për:

a) 2(dy) CCNA inxhinier. Minimum njeri të jete i diplomuar në Shkenca kompjuterilë apo inxhinier i clektrikes.

Minimum njeri të jete i diplomuar në Shkenca kompjuterike apo inxhinier i elektrikës,

Për këtë pozitë CCNA inxhinier, ne kerni ofruar 2 persona Siq janë Nikolche Davchevski dhe Bahrije Vardalth

Nikolchë Dovchevski është Inxhinier i Diplomuar ne Inxhinieri Elektrike dhe Teknologji Informative, për të cilin gjithashtu kemi baghkëngjitur Diplomën e Bachelor, si dhe certifikuar me Cisco CCNA sipas kërkesës.

Ndërsa, Bahrije Vardari, është e certifikuar ne Cisco CCNA, mirëpo nuk është e diplomuar ende Siq është e paraqitur dhe ne CV-ne e saj.

Sa i përket pjesës se kërkesës për pozitën CCNA ne si NOVOS kemi plotësuar kërkesën Sipos dosjes se tenderit duke paraqitur të paktën një inxhinier të diplomuar me bachelor dhe me certifikim CCNA

Duke pasur parasysh, kërkesën e DT-së, Kërkesën për sqarime të AK-së, Përgjegjien e OE-së dhe Dokumentet e prezantuara ne ofertë konstatoj se pretendimi ankimore është i pa bazuar.

Pretendimi ankimore nr.2 nga ana e Operatorit ekonomik është:

Pretendimi ankimor 2 nuk janë plotësuar kushtet ligjore qe të mund të përfundohet aktiviteti i prokurimit. përgjigje e ekspertit shlytues ndaj pretendimit ankimor 2 bazuar ne shlytimin e dokumentacioneve ne ofertë dhe krahasimit të tyre me pretendimet ankimore konstatoj se AK ka zbatuar nenin 59 si dhe nenin 62 paragrafi 1 pika 1.1 me rastin e aulimit të procedurës.

Neni 62 - Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

1. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërin nga arsyet:

1.1 një shkeljeje të ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Sipas të thënave më sipër, ekspertja shqyrtuese i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE “Infosoft Systems” SH.P.K., dhe “Novus” SH.P.K., Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtues është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin raportit të ekspertit shqyrtues. Me këtë rast Paneli Shqyrtues ka marrë në konsideratë edhe përgjigjen e dhënë nga OE ankues. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE “Infosoft Systems” SH.P.K., dhe “Novus” SH.P.K janë të pa bazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe qëllimin parësor të ankesës, Paneli konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, parashtrësit e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor. Në këtë rast, Paneli Shqyrtues konstatimet e tij i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të cilat mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit, sikurse në këtë rast.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktiviteti të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i saj janë të pranueshme dhe se Paneli me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes pa nevojë që të njëjtat të përsëriten sërish.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se të gjitha pretendimet e operatoreve ekonomik ankues janë të pabazuara. Andaj, Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik OE “Infosoft Systems” SH.P.K., duhet të refuzohet si e pabazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur të mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues “MINISTRIA E SHËNDETËSISË” për anulim lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Ri-tender “Mirëmbajtja e 70% te HW te SISH-it për Institucionet Shëndetësore” me nr. të prokurimit: 206-24-1735-2-1-1.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertës shqyrtuese, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertës shqyrtuese. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se të gjitha pretendimet e operatoreve ekonomik ankues janë të pabazuara. Andaj, Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik “Novus” SH.P.K duhet të refuzohet si e pabazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur të mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – “MINISTRIA E SHËNDETËSISË” për anulim lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Ri-tender “Mirëmbajtja e 70% te HW te SISH-it për Institucionet Shëndetësore” me nr. të prokurimit: 206-24-1735-2-1-1.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
- **OE - Infsoft Systems SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: